

NXITJET NË BËRJEN E BIZNESIT TË NELT-IT NËE AFRIKË

13.8.2020 - Partneri ynë shumëvjeçar në disa tregje të Europës dhe të Afrikës, P&G, vendosi që të modifikojë strategjinë e bërjes së biznesit në Afrikë. Kjo rezultoi me ndërprerjen e bashëpunimit të kompanisë Nelt dhe P&G në fushën e shpërndarjes në tregjet në Mozambik dhe në Zambia. Në tregun e tretë të përbashkët, në Angolë, bashkëpunimi i të dyja kompanive vazhdon, bashkë me kontratën e rinovuar dhe të përshtatur.

Pavarësisht nga kjo se ky ndryshim paraqet një nxitje të madhe për biznesin tonë, Nelt në këtë njeh rastin për transformimin dhe përparimin e strategjisë së vet të shpërndarjes së prodhimeve të konsumit të gjerë. Në lidhje me këtë, fokusi ynë kryesor në këtë moment është në riorganizimin e brendshëm dhe në tërheqjen intensive të partnerëve të rinj.

Vendosja organizative e jonë solli edhe deri në ndryshimet e personelit në ekipin tonë. Milosh Velimiroviç, drejtori ekzekutiv në tregjet e Afrikës, vendosi që karrierën e tij ta vazhdojë jashtë Grupit Nelt. Me këtë rast dëshirojmë që t'i japim mirënjohje punës së tij të përkushtuar dhe t'i dëshirojmë gjithë të mirat në ndërmarrjet e biznesit dhe ato private në të ardhmen.

Pandemia globale e shkaktuar nga virusi Covid-19, edhe nxitjet makroekonomike, gjithashtu ndikuan në mënyrë të ndjeshme në strategjinë tonë shumëvjeçare në Afrikë. Megjithatë, jemi të vendosur të vazhdojmë me realizimin e projekteve të planifikuara dhe të vendosim biznes të qëndrueshëm dhe shumëvjeçar në Afrikë.

Boris Maçak, nënkryetari për tregjet afrikane
Grupi Nelt